REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNAL - LIPJAN
DREJTORATI I INSPEKTORATIT

DREJTORIJA E INSPEKTORATIT

Datë :	**05.10.2021**
Referencë	**11-344/10**
Për :	**Imri Ahmeti-Kryetar i Komunës**
Kopje: **Kopje:**	**Fauz Xhemajli-Nënkryetar i Komunës** **Lulëzim Qerimi-Nënkryetar i Komunës**
Nga:	**Imer Rrustemi- Drejtori i Inspektoratit**
Lënda :	**Raporti i muajit-shtator**

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Inspektorët komunalë gjatë muajit shtatorë kanë punuar në bazë të Vendimeve të Qeverisë respektivisht Ministrisë të Shëndetësisë për respektimin e masave anti-covid si dhe në bazë të Ligjit 07-L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë covid-19.

I kemi inspektuar të gjitha bizneset duke filluar me qendrat tregtare dhe kemi vazhduar me depo dhe supermarkete si dhe gastronominë. Problemin ma të madh e kemi pas me gastronominë pasi që vendimi i M.SH ka qenë i harmonizuar me hapësirën e cila ishte parapara në bazë të Ligjit mbi Parandalimin e Duhanit në hapësirat e jashtme (me terasa). Këtu në këto terasa ju kemi bë presion kafiterive që 3 anë të terasës duhen me qenë të çelura deri në fund, ndërsa 2 anë të mbyllura (qatija dhe pjesa e përparme e restorantit apo kafiterisë). Në Komunën tonë kanë respektuar Vendimet e M.SH të gjitha bizneset e më theks të veçantë GASTRONOMIA, për të cilët jemi mirënjohës shumë.

Gjatë shtatorit inspektorët e trafikut kanë inspektuar edhe transportuesit publik si dhe ato-taxit.

Edhe transportuesit puplik i kanë respektuar masat e Qeverisë me 50% udhëtar më pak, në autobus nuk kemi hasur më shumë 25 deri 27 udhëtar ku të gjithë ishin me maska dhe në hyrje të autobusit kanë qenë dezinfektuesit me alkool 65-70%.

Inspektorët e ndërtimit i kanë përcjell ndërtimet pa leje në qytet dhe rrethin ku lejohet me Ligj të ndërtohet. Gjatë inspektimit kanë hasë duke u ndërtuar dy garazhda me konstruksion metalik të cilat ishin në fazën e themeleve të cilat ishin të ndaluara me shenja zyrtare pasi që nuk ishin të pajisur me leje ndërtimi.

Një rast tjetër kishte filluar të bëjë mbi ndërtim në qytet pa u kompletuar me dokumentacionit teknik në bazë të Ligjit të Ndërtimit dhe inspektoret e ndërtimit ja kanë ndaluar punimet duke ja vendosur shiritat zyrtar dhe ja kanë larguar punëtorët. Inspektorët e ndërtimit i kanë inspektuar edhe objekt ndërtimore me leje ndërtimi në bazë të kërkesave të pronarëve. Gjithashtu kanë përgatit raportet finale të objekteve ndërtimore me banim kolektiv për tu pajisur nga drejtorati i Urbanizmit me çertifikat të përdorimit.

Nga inspektori i mjedisit është bërë inspektimi i objektve me ndërtime të larta me banim kolektiv të cilat janë në ndërtim e sipër në lidhje me zbatimin e kushteve të lejes mjedisore komunale, investitorëve i është dhënë urdhëresë për grumbullimin e mbeturinave ku ato të vendosën në kotinjer i cili do të jetë në vend punishte gjatë gjithë kohës deri në përfundim të objektit, si dhe të zbatohen kushtet e LMK-së.

Janë kontrolluar deponit e egra të mbeturinave se mos po hasim keqbërës duke hedhë mbeturina për të marr masa ligjore ndaj tyre.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUE

I kemi inspektuar dhe përcjell gastronomin se a janë duke i respektuar masat anti- covid në bazë të rekomandimeve të IKSHPK-së si dhe vendimet e Ministrisë së Shëndetësisë me që nuk kemi pas kapacitet si komunë me zbatu vendimin e Qeverisë, Qeveria e ka plotësuar stafin nga AUV-i me inspektorë shtesë të cilët janë ardhë kohë pas kohe në Lipjan dhe kanë vepruar së bashku me policinë e Lipjanit. Në bashkëpunim me policinë kemi inspektuar edhe Aeroportin Ndërkombëtar "Adem Jashari" ku e kemi inspektuar administratën e aeroportit stafin në veçanti. Në Aeroport janë kontrolluar edhe pasagjert për respektimin e masave anti-covid si dhe bizneset të cilat operojnë brenda hapësirës së Aeroportit. Gjatë kontrollit nuk kemi hasur në mos zbatim të masave anti-covid në bazë të vendimit të Qeverisë.
Gjatë fillimit të muajit shtatorë ishte numri i të prekurve shumë i lartë me covid-19 ku u shtu aktiviteti për përgatitjen e vendimeve për vetë izolim.
Ka fundi i muajit shtatorë u vërejt rënje e madhe e të prekurve me virusin sars cov-2 ku numri ra në dy shifrorë rreth 50 në ditë në tërë Kosovën.
Në bazë të listave që vinë nga IKSHPK dhe QKMF –së së Lipjanit çdo pacienti që është i prekur me covid-19 ju kemi bërë vendime për vetizolim. Gjatë këtij muaji me kërkesën e një kompanie për asgjësim të mallit kemi asgjësuar mall jashtë përdorimit dh të dëmtuar rreth 3100 kg.
Gjatë këtij muaji ju kemi përgjigj edhe kërkesave të qytetarëve.

STATISTIKAT

Inspektorët	Gjithsej inspektime	Inspektime me procesverbal	Pranime teknik	Fletëparaqitje	Vendosje të shiritav zyrtarë	Kallëzim penal	Pëlqime sanitare	Vërejtje, njoftime, raporte	Mbyllje e përkohshme e lokaleve	Të hyra nga pranimet teknike	Vendime për vetë izolim	Punë me palë, ankesa , kërkesa	Lendet e pranuara	Lende te pezulluara, ekzekutuara gjygjesore	Gjoba mandatore	Biznese të paregjistruara dhe pa pranime teknike	Ins. i biznseve rreth respektimit të masave anti -Covid-19	Ins. I kafshëve në thertore	Menaxhim I tregjeve dhe i kontratave per ndertim	Aktvendime, ndalesa, urdhëresa, vendime ,shkresa	Inspektim me polici	Asgjësim malli me këkes ne një kompanie
Biznesi	157	34	13							250.00€		59				25			8	18		
Ambienti	33	17						3				12									1	
Sanitarët	562	25									305						230			2		3100 kg
Ndërtimi	51	24		4		1		12				4								6		
Trafiku	86	19						24				19		2					8		14	
Gjithsej	889	119	13	4		1		39		250.00€	305	94		2		25	230		16	26	15	3100 kg

DISKUTIMET PUBLIKE

Diskutime publike për arsye të pandemisë covid-19 nuk kemi mbajtur.

TAKIME TË TJERA

Takime i kemi mbajt në mënyrë individuale me qytetar dhe pronar të bizneseve.

SFIDAT

Si sfidë kryesore për inspektorat vazhdon të mbetet gjendja pandemike.

REKOMANDIMET

Rekomandojmë qytetarët e Komunës sonë që të t'ju përmbahen rekomandimeve të IKSHPK-së si dhe urdhëresës së M.SH të Republikës së Kosovës.